



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1373, datë 10 .09. 2010

Për

“Disa ndryshime në Rregulloren “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.1300 date 14.06.2010”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.09.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për disa ndryshime në Rregulloren “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 “Për miratimin e Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Qëndrimit të AKEP për Komentet e Konsultimit Publik”

B A Z A L I G J O R E:

1. Nenet 1, 2, 3, 10, 13 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05,1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 8485*);

2. Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
3. Pika 3 e nenit 23 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Shkresë nr. 2703, datë 21.07.2010 “Vërejtje dhe komente për Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit” të miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010, e Shoqatës së Operatorëve Alternativë të Telekomunikacioneve (*shkresa e SHOA*);
- Projektvendim për KD (*projektakti*);
- Memo sqaruese (*memo*);
si dhe,
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Me Vendimin nr.1300, datë 14.06.2010, “Për miratimin e Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Qëndrimit të AKEP për Komentet e Konsultimit Publik”, Keshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dokumentet rregullatore:
 - Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionin;
 - Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP.
2. Shoqata e Operatorëve Alternativë të Telekomunikacioneve me shkresën nr. 2703, datë 21.07.2010, ka paraqitur në AKEP vërejtje dhe komente për Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit” të miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010, konkretisht mbi formulimin e pikës 9 të nenit 5, sipas të cilit “ *në rastet kur një operator (mbi shkaqe të bazuara) dyshon se pala tjetër modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të percjella nga kjo palë, operatori ka të drejtë të pezullojë ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, duke njoftuar operatorin në shkelje dhe AKEP-in*”;
3. SHOA arsyeton se paragrafi i sipërcituar në këtë mënyrë përbën një dispozitë jo të balancuar dhe është favorizues për operatorët me FNT, duke kërkuar ndërhyrjen urgjente të AKEP për ndryshimin e tij;
4. Akti normativ administrative “Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionin” është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, si i tillë ky dokument në asnjë rast nuk duhet të lejojë hapësira interpretative të ndryshme për palët e interesit. Dispozita në fjalë megjithëse përmban përcaktimin “*mbi shkaqe të bazuara*”, termi i përdorur “*dyshon*” mund të

bëhet burim keqinterpretimi ndryshe nga qëllimi dhe vullneti i mirë i AKEP, duke i çuar palët në mospajtime dhe përceptime të gabuara nisur nga pozitat e interesave të ngushta,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij dokumenti rregullator për tregun e komunikimeve elektronike, parimet e ligjit nr. 8485 të materializuara në nenet 10 dhe 13 të tij dhe teknikën legjislative, bazuar në nenet 1, 2, 3, dhe 128 të ligjit nr. 8485, pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar;

si dhe duke e konsideruar të drejtë vërejtjen e paraqitur nga SHOA,

V E N D O S I:

1. Pika 9 e nenit 5 të Rregullores “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 ndryshon dhe bëhet:

“9. Në rastet kur një operator në bazë të provave që disponon faktin se pala tjetër modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të përcjella nga kjo palë, operatori ka të drejtë të paralajmërojë me shkrim operatorin në shkelje duke njoftuar njëkohësisht dhe AKEP-in, për pezullimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit, nëse në mënyrë të menjëhershme dhe në çdo rast jo më vonë se brenda një afati prej 24 orësh nga marrja e njoftimit, nuk ndërpritet shkelja e konstatuar. Në njoftimin e dërguar përfshihen provat që faktojnë shkeljen e pretenduar, seritë numerike të cilat janë keqpërdorur, si dhe masa e pezullimit që do të merret nga operatori ankimes nëse shkelja nuk ndërpritet brenda afatit të caktuar. Brenda këtij afati, operatori në shkelje duhet të ndërpresë menjëherë shkeljen e njoftuar ose nëse pretendon se nuk ka kryer asnjë shkelje të paraqesi kundërshtimet dhe provat e tij pranë operatorit njoftues dhe AKEP, duke i njoftuar paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda 5 ditëve kalendarike të paraqesi provat që disponon”;

2. Pika 10 e nenit 5 të Rregullores “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 ndryshon dhe bëhet:

“10. Operatori i njoftuar për shkeljen ka detyrimin që të përgjigjet menjëherë kundrejt njoftimit të marrë.

- a) *Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen nuk e ndërpret atë brenda afatit të caktuar në njoftim ose nëse pretendon se nuk e ka kryer shkeljen, nuk njofton paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda afatit 5 ditor nuk paraqet provat që vërtetojnë pretendimin e tij, atëhere operatori që ka bërë njoftimin për shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit sipas njoftimit të bërë;*
- b) *Në se operatori i njoftuar për shkeljen nuk ndërpret shkeljen e faktuar brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit ose nuk dërgon mesazhin paraprak se nuk është në*

- shkelje dhe për këtë do të dërgojë provat e tij brenda 5 ditëve, atëhere operatori i dëmtuar pezullon në fund të këtij afati ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit;*
- c) Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të paraqesi brenda afatit provat e tij dhe në përfundim të këtij afati nuk paraqet asnjë provë, atëhere operatori i dëmtuar ndërpret pas 5 ditëve nga njoftimi i bërë, ofrimin e shërbimeve të inrekoneksionit;*
- ç) Operatori në shkelje është përgjegjës për shkeljen e kryer nëse provat e paraqitura prej operatorit të dëmtuar vërtetohen nga AKEP dhe për këtë me vendim të arsyetuar e ndëshkon atë me masa administrative në përputhje me përcaktimet ligjore për këtë qëllim;*
- d) Operatori që pretendon shkeljen është përgjegjës nëse pretendimet e tij për shkelje nuk vërtetojnë shkeljen e pretenduar. Në një rast të tillë AKEP me vendim të arsyetuar mban qëndrim dhe vendos masa administrative kundrejt këtij operatori;*
- e) Secila nga palët ka të drejtë që t'i drejtohet AKEP-it për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores “Për procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” miratuar me Vendim të Këshillit drejtues të AKEP nr. 1296 date 11.06.2010 si dhe Gjykatës kompetente për të apeluar vendimin e AKEP-it;*
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al ;

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE